



6 dhjetor 2019

CEPEJ(2019)18

Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ)

Instrumenti i Zhvillimit të Ndërmjetësimit

Sigurimi i zbatimit të Udhëzimeve të CEPEJ për ndërmjetësimin

PROGRAMI NDËRGJEGJËSIMI I NDËRMJETËSIMIT PËR GJYQTARË

sigurimi i efikasitetit të referimit gjyqësor për ndërmjetësim

Dokument i krijuar me kontributin e Grupit të Magjistratëve Evropianë për Ndërmjetësim (GEMME)



***Ashtu siç është miratuar në Mbledhjen e 33-të plenare të
CEPEJ në Strasburg, 5 dhe 6 dhjetor 2019 në funksion të
miratimit të tij***

Është pranuar se gjyqtarët luajnë rol vendimtar në kultivimin e një kulture të zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjeve. Ata duhet të jenë në gjendje të japin informata, të organizojnë sesione informative mbi ndërmjetësimin dhe, kur është e mundur, të ftojnë palët të përdorin ndërmjetësimin dhe/ose t'i referojnë rastet në ndërmjetësim. Prandaj është thelbësore që ata të kenë njohuri dhe të kuptojnë plotësisht procesin dhe përfitimet nga ndërmjetësimi.

Qëllimi i këtij mjeti është të rrisë ndërgjegjësimin e gjyqtarëve për ndërmjetësimin në çështje civile dhe familjare, çështje penale (të rriturit dhe të miturit) dhe çështje administrative. Ky mjet për analogji mund të përdoret nga profesionistë të tjerë ligjorë që i referohen ndërmjetësimit si prokurorët dhe autoritetet dhe institucionet e tjera gjyqësore që ofrojnë trajnime për ta. Kjo është kuptuar që të hapet qasja ndaj ndërmjetësimit për palët ndërgjyqësore duke përmirësuar aftësinë e gjyqtarëve për të kryer një referim efektiv gjyqësor ndaj ndërmjetësimit dhe jo për t'i bërë gjyqtarët ndërmjetës në ushtrimin e funksionit të tyre gjyqësor.

Kjo është frymëzuar nga programet e trajnimit dhe ndërgjegjësimit të kryera në Belgjikë, Francë dhe Zvicrën frëngjishtfolëse, të transmetuara dhe komentuara me dashamirësi nga trajnerët e mëposhtëm: Gjyqtarët Avi SCHNEEBALG, trajner për gjyqtarët belgë në *Institut de formation judiciaire* të Brukselit, Fabrice VERT, trajner për gjyqtarët francezë në *Ecole Nationale de la Magistrature* në Bordeaux, dhe Jean A. MIRIMANOFF, gjyqtar nderi, ndërmjetës, trajner për Fondacionin për trajnimin e vazhdueshëm të gjyqtarëve zviceranë.

Ekziston një gamë e gjerë e praktikave të ndryshme të mësimdhënies dhe ndërmjetësimit brenda shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Megjithatë, ky mjet është krijuar që të jetë lehtësisht i adaptueshëm në situata të ndryshme kombëtare.

Ky mjet është zhvilluar duke iu referuar pikës 3. Vetëdijësimi për Udhëzimet e CEPEJ për ndërmjetësim.

1. Konteksti i mjetit

- Rekomandimi Rec(2002)10 për ndërmjetësimin në çështje civile, K. VII: "Shtetet duhet të ofrojnë informacion për ndërmjetësimin në çështjet civile për profesionistët e përfshirë në funksionimin e drejtësisë".
- Udhëzimet për një zbatim më të mirë të rekomandimit ekzistues në lidhje me ndërmjetësimin familjar dhe ndërmjetësimin në çështjet civile, CEPEJ(2007)14, Nr. 50: Gjyqtarët luajnë rol vendimtar në kultivimin e një kulture të zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjeve. Prandaj është thelbësore që ata të kenë njohuri dhe të kuptojnë plotësisht procesin dhe përfitimet nga ndërmjetësimi. Kjo mund të arrihet përmes sesioneve informative si dhe programeve të trajnimit fillestar dhe gjatë shërbimit, të cilat përfshijnë elemente specifike të ndërmjetësimit të dobishëm në punën e përditshme të gjykatave në juridiksione të veçanta".
- Udhërrëfytesa CEPEJ(2018)8 bazuar në raportin e CEPEJ-GT-MED për "Ndikimin e Udhëzimeve të CEPEJ mbi Ndërmjetësimin Civil, Familjar, Penal dhe Administrativ", i miratuar më 27 qershor 2018, Rek. 3, f. 4: "Pa një ndërgjegjësim/trajnim të detyrueshëm të ndërmjetësimit të gjyqtarëve gjatë shkollimit ose në vitin e parë të praktikës së tyre gjyqësore, numri i lëndëve të referuara për ndërmjetësim në çështjet civile, familjare, penale (të rritur dhe të mitur) dhe administrative do të mbetet i pandryshuar në numrin aktual të parëndësishëm", dhe tabela e tij 2.1: "Zhvilloni dhe shpërndani mjete trajnimi për të rritur trajnimin e detyrueshëm dhe ndërgjegjësimin për ndërmjetësimin midis avokatëve dhe gjyqtarëve".

2. Qëllimet e përgjithshme të programeve të ndërgjegjësimit për ndërmjetësim

Çdo program **ndërgjegjësimi fillestar** duhet të synojë të fuqizojë gjyqtarët që:

- Të kenë njohuri për metodat e ndryshme ADR dhe të dinë të dallojnë mënyrën e duhur për një situatë të caktuar;
- Të kuptojnë konfliktin dhe mënyrën për ta bërë atë pozitiv;
- Të hapin qasjen për ndërmjetësim nëpërmjet një referimi gjyqësor efikas, i cili përfshin njohuritë se si të:
 - a) Identifikojnë dhe përzgjedhin lëndët që janë të përshtatshme për ndërmjetësim;
 - b) Kuptojnë karakteristikat, parimet, objektivat, qasjet dhe metodat e ndërmjetësimit, si dhe funksionimin e procesit të tij, në mënyrë që t'u ofrojnë informacion adekuat palëve ndërgjyqësore dhe avokatëve të tyre mbi ndërmjetësimin;
 - c) Sugjerojnë, propozojnë ose drejtojnë palët për të marrë pjesë në një sesion informativ

- ndërmjetësimi të ofruar nga një qendër ndërmjetësimi ose ndërmjetës të kualifikuar;
- d) Lehtësojnë kalimin e palëve ndërgjyqësore nga procedura gjyqësore në procesin e ndërmjetësimin.

Përmbajtja e trajnimit dhe metodologjisë së trajnimit do të marrë parasysh kontekstin, nivelin fillestar të njohurive dhe ekspertizën praktike të të trajnuarve. Kontrolli i cilësisë dhe masat e pavarura monitoruese duhet të vendosen për të siguruar përmbajtje të mjaftueshme dhe ofrimin e trajnimit. Rekomandohet fuqimisht që ofrimi i pjesëve praktike të trajnimit duhet të udhëhiqet nga ndërmjetësues aktivë - gjyqtarë si dhe ndërmjetësues aktivë jo gjyqtarë, me përvojë si trajnerë.

Programi për **ndërgjegjësim të vazhdueshëm** duhet të rifreskojë njohuritë dhe praktikën e gjyqtarëve në çështjet e referimit gjyqësor në ndërmjetësim, në përsëritjen e programit të gjysmë ditës së 2-të dhe të 3-të (krh. Shtojcën 2).

3. Objektivat specifike që lidhen me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar

- Sigurimi i njohurive për legjislacionin kombëtar të gjyqtarëve në fushat e tyre në çështjet civile dhe familjare, çështjet penale (të rriturit dhe të miturit) dhe çështjet administrative.
- Përgatitja e gjyqtarëve për të marrë pjesë në një projekt pilot ndërmjetësimi në juridiksionin e vet.
- Përmirësimi i aftësisë pajtuese të gjyqtarëve me përdorimin e mjeteve të ndërmjetësimin (komunikim aktiv dhe negociim parimor – i bazuar në interes), aty ku lejohet ose parashikohet me ligj.

4. Kohëzgjatja e trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm

Kohëzgjatja mbi katër gjysmë ditë (gjithsej dy ditë të plota) rekomandohet sa herë që është e mundur për programet e trajnimit fillestar.

Një ose dy seancat gjysmë-ditore rekomandohen në një frekuencë të rregullt për programet e trajnimit të vazhdueshëm.

5. Burimet e nevojshme për trajnerët dhe asistentët

Burimet e kërkuara do të varen nga numri i pjesëmarrësve. Për një grup prej 24 gjyqtarësh, pjesëmarrja e një trajneri të kualifikuar (ndërmjetësues i akredituar, i pajtuar, i betuar) dhe një ekipi prej tre asistentësh siguron një efektivitet të mirë në rritjen e ndërgjegjësimin. Në mënyrë ideale, raporti trajner-trajnuar duhet të jetë 1 trajner me 10 të trajnuar/15 të trajnuar në maksimum.

6. Ambientet

Kur programi sensibilizues zhvillohet në vitin e parë të praktikës së tyre gjyqësore, rekomandohet që ai të zhvillohet brenda objekteve të drejtësisë ose pranë tyre.

7. Doracakë të rekomanduar

Mjetet e miratuara nga CEPEJ (CEPEJ(2018)7), në veçanti:

- Udhëzues i referimit gjyqësor për ndërmjetësim;
- Lista kontrolluese e menaxhimit dhe lista kontrolluese e monitorimit pilot;
- Doracakë kombëtar dhe një bibliografi e shkurtër për gjyqtarët.

8. Rekomandime për autoritetet gjyqësore të shteteve anëtare

Për të siguruar efikasitetin e programeve të ndërgjegjësimin/trajnimit (d.m.th. qëndrueshmëria e tyre, shpeshësia dhe cilësia e tyre) do të ishte e përshtatshme të merren masat e mëposhtme:

1. Caktimi, në çdo gjykatë apeli, i një gjyqtari përgjegjës për ndërmjetësimin, për vëzhgimin e ndërgjegjësimin të gjyqtarëve dhe për projektet pilot
2. Caktimi, në çdo juridiksion, i një gjyqtari përgjegjës për organizimin e këtyre programeve
3. Për të siguruar që ky gjyqtar do të marrë vetë një formacion të plotë ndërmjetësimi, në mënyrë që të jetë në gjendje të bëhet trajneri kryesor i ndërgjegjësimin të ndërmjetësimin të gjykatës së tij/saj dhe të jetë në gjendje të organizojë pilot projektin e ndërmjetësimin në juridiksionin e tij/saj

Kurrikula bazë për referim gjyqësor

1. Zhvillimi i njohurive

Kurrikula e trajnimit duhet të mbulojë të paktën këto fusha kryesore të zhvillimit të njohurive:

1.1 Ndërmjetësimi – përkufizimi dhe koncepti

1.2 Zgjidhja tradicionale e mosmarrëveshjeve dhe ndërmjetësimi

1.3 Parimet themelore të ndërmjetësimit

1.4. Fazat e ndërmjetësimit:

- a. Përgatitja
- b. Hapja
- c. Eksplorimi
- d. Negocimi
- e. Marrëveshja

1.5. Indikacionet dhe kundërindikacionet e ndërmjetësimit në vlerësimin e përshtatshmërisë së rasteve

1.6. Cilësitë e kërkuara nga gjyqtarët që inkurajojnë palët të ndërmjetësojnë

1.7. Rolet e palëve, mbrojtësit e tyre dhe pjesëmarrësve të tjerë në ndërmjetësim

1.8. Koha e nxitjes së ndërmjetësimit

1.9 Kuadri ligjor i ndërmjetësimit dhe legjislacioni në lidhje me ndërmjetësimin, duke përfshirë rishikimin e kuadrit ligjor për ndërmjetësim të detyrueshëm dhe të zgjedhur nëse është i disponueshëm

1.10 Ndërveprimi ndërmjet ndërmjetësuesve, gjyqtarëve, avokatëve, përdoruesve të ndërmjetësimit dhe palëve të tjera të interesit të ndërmjetësimit

1.11. Elementet e një interviste referimi:

- a. Diagnoza e konfliktit
- b. Plani i ndërhyrjes
- c. Eksplorimi i vullnetit për të negociuar dhe përmirësimi i tij
- d. Niveli i përshkallëzimit
- e. Informacion mbi ndërmjetësimin

1.12. Karakteristikat kryesore dhe dallimet e ndërmjetësimit në çështjet civile, familjare, penale dhe administrative

2. Trajnim i shkathtësive praktike

Për sa i përket zhvillimit të shkathtësive, temat thelbësore të shkathtësive që duhet të mbulohen, demonstrohen dhe praktikohen në çdo program trajnimi janë:

- a. Format e shkathtësive të të dëgjuarit dhe strategjive të komunikimit, veçanërisht kur marrin pjesë grupe të cënueshme (fëmijë, viktimat dhe kategori të tjera që kërkojnë vëmendje të veçantë)
- b. Parashtrimi i pyetjeve të duhura
- c. Mënyrat e reagimit ndaj sjelljeve të ndryshme të palëve
- d. Motivimi dhe përgatitja e palëve dhe avokatëve
- e. Shkathtësitë e analizës së rastit, duke përfshirë përzgjedhjen e arsyeshme të strategjisë dhe metodave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Kurset e trajnimit për referim gjyqësor duhet të jenë pjesëmarrëse, ndërvepruese dhe të fokusuar tek nxënësit. Për të siguruar këtë, duhet të përdoren një sërë metodologjish mësimore, duke përfshirë ligjërimin, videot, ushtrimet ndërvepruese, punën individuale, diskutimin në grup, të folurit në dyshe dhe luajtjen e

roleve. Si udhëzim, për pjesën praktike të çdo kursi, që është krijuar për të mësuar procesin dhe shkathhtësitë për të qenë një gjyqtar referues efektiv, një pjesë thelbësore duhet t'i kushtohet lojës së roleve, stërvitjes dhe reagimeve, si dhe diskutimeve dhe ushtrimeve.

Shtojca 2

Shembull konkret i trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm

1) Shembull konkret i një programi trajnimi fillestar - organizimi dhe përmbajtja

Koha është e ndarë në ligjërata të ndjekura nga tryeza të rrumbullakëta, punëtori dhe lojëra me role në mënyrë interaktive, me një gjysmë dite kushtuar specifikave kombëtare. Kohëzgjatja ka vetëm një vlerë treguese dhe mund të modifikohet sipas nevojave specifike. Shih edhe k.10. Rekomandime për autoritetet gjyqësore.

Gjysmë dita e parë

- A) Hyrje në ADR dhe vendi i ndërmjetësimit kundrejt zgjidhjes tradicionale të mosmarrëveshjeve (ligjëratë 45 min. dhe tryeza e rrumbullakët 15 min.);
- B) Konflikti dhe mosmarrëveshja juridike (ligjëratë 45 min. dhe tryeza e rrumbullakët 15 min.);
- C) Ndërmjetësimi: parimet, avantazhet dhe kufizimet (ligjëratë 45 min.) / Tryezë e rrumbullakët dhe debate për konfidencialitetin (15 min.);
- D) Ndërmjetësimi dhe pajtimi (ligjëratë 30 min.) dhe ushtrime për raste praktike (30 min). Për ndërmjetësimin (MS) që nuk e dinë pajtimin: Qasjet dhe format e ndërmjetësimit (parandalimi dhe riparimi)

Vlerësimi i gjysmë ditës

Gjysmë dita e dytë

- A) Komunikimi aktiv (ligjëratë 30 min. dhe ushtrime praktike 30 min.)
- B) Negocimi parimor (i bazuar në interes) dhe zbatimi i tij në të drejtën bashkëpunuese dhe në procesin e ndërmjetësimit (ligjëratë 15 min. dhe ushtrime 45 min.)
- C) Procesi i ndërmjetësimit dhe fazat e tij, rolet e palës së tretë, të palëve dhe të këshilluesve / avokatëve (ligjëratë 30 min.)
Rast studimor: lojë me role (90 min.)
- D) Cilësitë e gjyqtarëve që referojnë çështjet në ndërmjetësim (tryeza e rrumbullakët 30 min.)

Vlerësimi i gjysmë ditës

Gjysmë dita e tretë

Intervista e referimit gjyqësor dhe hapat e saj:

- A) Identifikimi dhe përzgjedhja e lëndëve (ligjëratë 15 min.) dhe rastet praktike (45 min.)
- B) Informacion mbi ndërmjetësimin (ligjëratë 15 min.) dhe lojë me role, të tilla si në seancën dëgjimore (45 min.): simulimi i shkëmbimeve midis gjyqtarit, palëve dhe avokatëve të tyre, eksplorimi i vullnetit për të negociuar dhe rritja e tij, argumente *pro and contra*, kundërshtime dhe kundërkundërshtime
- C) Mënyra e referimit për ndërmjetësim dhe mbështetje për palët gjatë kalimit nga procedura gjyqësore në procesin e ndërmjetësimit: Ligjëratë (15 min.) dhe tryezë e rrumbullakët (45 min.)

Vlerësimi i gjysmë ditës

Gjysmë dita e katërt

Specifikat kombëtare duke përfshirë kuadrin ligjor të ndërmjetësimit

Pesë grupe të veçanta, nëse aplikohen, për ndërmjetësim në çështje:

- A) Familjare
- B) Civile
- C) Penale (të rritur)
- E) Penale (të mitur) dhe
- F) Administrative

- Referimi gjyqësor për ndërmjetësim;
- Përdorimi i mjeteve të ndërmjetësimit nga gjyqtari i pajtimit

- Forcimi i zgjidhjeve të ndërmjetësimit: ratifikimi dhe aktet autentike të detyrueshme. Aspektet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Vlerësimi i gjysmë ditës dhe i trajnimit

2) Shembull konkret i trajnimit të vazhdueshëm

Gjysmë dita e parë

- A) Komunikimi aktiv (ligjëratë 30 min.) dhe ushtrime praktike (30 min.)
- B) Negocimi parimor (i bazuar në interes) dhe zbatimi i tij në të drejtën bashkëpunuese dhe në procesin e ndërmjetësimit (ligjëratë 15 min. dhe ushtrime 45 min.)
- C) Procedurë e procesit të ndërmjetësimit dhe fazat e saj, rolet e palës së tretë, të palëve dhe të këshilluesve / avokatëve (ligjëratë 30 min.)
Rasti studimor: lojë me role (90 min.)

Vlerësimi i gjysmë ditës

Gjysmë dita e dytë

Intervista e referimit gjyqësor dhe hapat e saj:

- A) Identifikimi dhe përzgjedhja e lëndëve (ligjëratë 15 min.) dhe rastet praktike (30 min.)
- B) Informacion mbi ndërmjetësimin (ligjëratë 15 min.) dhe lojë me role, të tilla si në seancën dëgjimore (30 min.): simulimi i shkëmbimeve midis gjyqtarit dhe palëve ndërgjyqësore të tij/saj dhe këshilluesve/avokatëve të tyre, eksplorimi i vullnetit për të negociuar dhe rritja e tij, argumente *pro and contra*, kundërshtime dhe kundërkundërshtime
- C) Mënyra e referimit për ndërmjetësim dhe ndihmës për palët gjatë kalimit nga procedura gjyqësore në procesin e ndërmjetësimit: Ligjëratë (15 min.) dhe tryezë e rrumbullakët (30 min.)

Vlerësimi i gjysmë ditës dhe i trajnimit